



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM



Nr. 2584 Prot.

Tiranë, më 24.07 2019

Lënda: Dërgohet dekreti i Presidentit të Republikës, me nr. 11235, datë 23.07.2019.

KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

TIRANË

Bashkëlidhur, Ju dërgojmë dekretin e Presidentit të Republikës nr. 11235, datë 23.07.2019, për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 42/2019, 'Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar", së bashku me arsyet e kthimit të ligjit.

Ju faleminderit!

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Ornela Zonja





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI**

D E K R E T

“PËR

**KTHIMIN E LIGJIT NR. 42/2019 ‘PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 107/2014 “PËR PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E
TERRITORIT”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 85, pika 1 dhe 93, të Kushtetutës,

D e k r e t o j

Kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 42/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014 ‘Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit’, të ndryshuar”, me qëllim rishikimin dhe përmirësimin e nenit 8 të këtij ligji, sipas arsyesimit bashkëlidhur.

**Nr. Dekreti 11235
Tiranë, më 23.07.2019**

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

ILIR META



Arsyet e kthimit të ligjit nr. 42/2019

“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014 ‘Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit’, të ndryshuar”.

Kuvendi i Shqipërisë, në seancën plenare të datës 4 korrik 2019, ka miratuar ligjin nr. 42/2019, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014 ‘Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit’, të ndryshuar”.

Me shkresën e Kuvendit të Shqipërisë nr. 2710 prot., datë 08.07.2019, ky ligj është përcjellë për dekretim dhe shpallje dhe është administruar në Institucionin e Presidentit të Republikës me nr. 2161 prot., datë 08.07.2019.

Sipas praktikës parlamentare, qëllimi i ndryshimeve të propozuara është zgjidhja e disa problematikave të ndeshura nga zbatimi në praktikë i ligjit ekzistues, të cilat kanë vënë në dukje nevojën për të saktësuar disa aspekte teknike dhe procedurale në shqyrtimin e kërkesave për lejendërtimi, si dhe shpërndarjen e kompetencave të autoritetet përkatëse.

Ndryshimet ligjore janë nismë propozuese e Këshillit të Ministrave dhe janë përgatitur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si ministri përgjegjëse për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Nga shqyrtimi i relacionit të Këshillit të Ministrave rezulton se projektligji nuk është konsultuar me ministrinë e tjera që lidhen me përmbajtjen dhe efektet e aktit, apo me grupet e interesit. Projektligji është diskutuar dhe shqyrtuar në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin si komision përgjegjës në Kuvendin e Shqipërisë. Në relacionin shoqërues të projektligjit bëhet me dije se, shqyrtimi i tij është kryer me procedurë të përshpejtuar, bazuar në vendimin nr.73, datë 20.6.2019, të Kuvendit të Shqipërisë.

Sipas raportit të komisionit, miratimi i ligjit është i domosdoshëm për të përmirësuar procesin e zhvillimit të territorit si për sa i përket saktësisht të procedurave dhe afateve, ashtu dhe për saktësimin e kompetencave të autoriteteve të planifikimit/zhvillimit.

Konkretisht, ligji nr. 42/2019 përmban 9 nene, nëpërmjet të cilave ndryshojnë apo bëhen shtesa që konsistojnë në:

- Përcaktimin e kompetencës për Këshillin Kombëtar të Territorit për të miratuar rregullore të veçanta lidhur me kushtet e zhvillimit për tipologjitë e zhvillimeve që janë kompetencë e këtij organi;
- saktësimin e procedurës së ndryshimit të burimeve të tokës në zonat për të cilat ka dokumente planifikimi dhe lejezhvillimi të miratuara nga autoritetet e zhvillimit dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës;
- zgjatjen e afatit ligjor për miratimin e lejeve të ndërtimit në përputhje me përcaktimet e vendosura në Rregulloren e Zhvillimit të Territorit dhe në sistemin “e-leje”, nga 60 ditë kalendarike që është aktualisht në 60 ditë pune;

- saktësimin e kompetencave të organeve kompetente jo vetëm për të rishikuar kushtet e lejes së ndërtimit, por dhe ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit

Presidenti i Republikës shqyrtoi ligjin nr. 42/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014 ‘Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit’, të ndryshuar,” duke iu referuar përmbajtjes së aktit të dërguar për dekretim dhe shpallje, praktikës parlamentare të ndjekur për këtë qëllim, legjislacionit aktual në fuqi, si dhe vlerësoi përputhshmërinë e aktit të miratuar, duke bërë një analizë të përmbajtjes së tij në raport me respektimin e parimeve kushtetuese dhe interesin publik.

Në përfundim të shqyrtimit, Presidenti i Republikës çmon se neni 8 i ligjit nr. 42/2019, i paraqitur për shpallje, është jo i plotë dhe i paqartë në formulim. Për këtë shkak, zbatimi i këtij neni sipas formulimit aktual, mund të sjellë aplikim të gabuar në praktikë apo keqinterpretim me pasojë cenimin e parimit kushtetues të sigurisë juridike dhe të interesit publik.

Bazuar në këtë konstatim, Presidenti i Republikës vlerëson se është çasti që neni 8 i ligjit nr. 42/2019 duhet të rishikohet edhe një herë nga Kuvendi me qëllim përmirësimin, plotësimin dhe qartësimin tërësor të dispozitës ligjore, në mënyrë që aplikimi i saj jo vetëm të sigurojë një bazë ligjore të shëndoshë për organet publike, por të garantojë që të drejtat e pronësisë të shtetasve apo çdo e drejtë tjetër reale e lidhur me të, të mbrohet dhe të mos cenohet nga zbatimi në praktikë i këtij ndryshimi ligjor.

Bazuar mbi këtë arsyetim, të shpjeguar si më poshtë vijon, në bindje të Kushtetutës dhe në ushtrim të së drejtës të parashikuar në pikën 1 të nenit 85 të saj, Presidenti i Republikës vlerëson se ligji nr. 42/2019, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014 ‘Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit’, të ndryshuar,” i duhet kthyer Kuvendit me qëllim rishikimin dhe përmirësimin e nenit 8 të këtij ligji.

Konkretisht:

Nëpërmjet nenit 8 të ligjit nr. 42/2019, Kuvendi i Shqipërisë ka parashikuar disa shtesa në nenin 48 të ligjit aktual nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar”.

Në nenin 48 të ligjit aktual që synohet të ndryshohet, sanksionohet:

“Neni 48

Rishikimi i kushteve të lejes

1. *Kushtet e tjera të lejes së ndërtimit dhe projekti i zbatimit mund të rishikohen në rast se gjatë kryerjes së punimeve të ndërtimit hasen situata të paparashikuara ekonomike dhe teknike që e bëjnë të pamundur realizimin e projektit të miratuar me lejen e ndërtimit.*
2. *Rishikimi kryhet nga autoriteti që e ka miratuar lejen, mbi kërkesën e arsyetuar të subjektit të pajisur me leje ndërtimi, të shoqëruar me relacionin përkatës, të firmosur nga projektuesi dhe mbikëqyrësi i punimeve.*

3. Kushtet e tjera të lejes dhe procedura e rishikimit të tyre, sipas përcaktimeve të këtij neni, kryhet sipas rregullores së zhvillimit.”

Ndërkohë, në nenin 8 të ligjit nr. 42/2019, të paraqitur për dekretim dhe shpallje, parashikohet shprehimisht:

“Neni 8

Në nenin 48 bëhen ndryshimet, si më poshtë:

1. Në titullin e nenit, pas fjalëve ‘Rishikimi i kushteve të lejes’ shtohen fjalët **‘dhe ndryshimi i projektit gjatë ndërtimit’**.
2. Në pikën 2, pas fjalës ‘Rishikimi’, shtohen fjalët **‘i kushteve apo ndryshimi i projektit gjatë ndërtimit’**.
3. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë: ‘3. Rastet kur kërkohet rishikimi i kushteve apo ndryshimi i projektit gjatë ndërtimit, si dhe procedura, sipas përcaktimeve të këtij neni, kryhen sipas rregullores së zhvillimit.’”

Pra, nëpërmjet këtyre ndryshimeve ligjore, bëhet e mundur që tashmë gjatë kryerjes së punimeve të ndërtimit mund të realizohet si rishikimi i kushteve të lejes, ashtu edhe ndryshimi i projektit gjatë ndërtimit.

Dispozita e nenit 48 të ligjit aktual, e cila synon të ndryshohet me propozimet e ligjit nr. 42/2019, objekt shqyrtimi, rregullon pa dallim si rastet e investimeve private, ashtu dhe realizimin e veprave publike.

Sipas raportit të Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, ky ndryshim është propozuar me qëllim saktësimin e terminologjisë në emërtimin e një kategorie lejeje, ku konkretisht, parashikohet që përveç rishikimit të kushteve të lejes të parashikohet edhe ndryshimi i projektit gjatë ndërtimit.

Në pamje të parë, dispozita e propozuar për ndryshim, duket se nuk paraqet problematikë, pasi në praktikën rutinë të zhvillimit të veprave ndërtimore që kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi nga organi kompetent kushtet e lejes së ndërtimit dhe projekti i zbatimit mund dhe të rishikohen, në rast se gjatë kryerjes së punimeve të ndërtimit hasen situata të paparashikuara ekonomike dhe teknike, që e bëjnë të pamundur realizimin e projektit të miratuar me lejen e ndërtimit.

Nëse do ta analizojmë të gjithë procesin brenda një sipërmarrjeje private mbi mënyrën sesi zyrtarizohet vullneti i pronarëve të pasurive pronë private që përfshihen në një proces zhvillimi apo ndërtimi, aplikimi i pikës 2, të nenit 8 të ligjit nr. 42/2019, mund të sjellë problematikë dhe konflikt të vazhdueshëm midis sipërmarrësve apo investorëve me pronarët e pasurive pronë private, mbi të cilat realizohet ndërtimi/vepra.

Referuar dispozitave të Kodit Civil, ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, të ndryshuar”, dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, dokumentacioni që vërteton pronësinë

apo të drejtat e ligjshme për pasuri private është një nga dokumentet e nevojshme që verifikon autoriteti publik (Këshilli Kombëtar i Territorit apo Kryetari i Bashkisë) në procedurat e miratimit të akteve të zhvillimit të parcelave në territor përmes hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit apo nëpërmjet planeve të detajuara vendore.

Në referim të marrëveshjeve të bashkëpunimit që pronarët e pasurive, pronë private, lidhin me investitorët apo sipërmarrësit (kontratave të porosisë, sipërmarrjes etj.), këta të fundit, bazuar në nenin 38 dhe 39 të ligjit nr. 107/2014, parashtrajnë kërkesat e tyre përpara autoritetit të pushtetit vendor apo KKT-së, për zhvillimin e një zone të caktuar dhe për pajisjen me leje ndërtimi sipas projekteve paraprake të propozuara prej tyre.

Sipas ligjit nr. 107/2014, leja e zhvillimit është dokumenti i lëshuar nga autoriteti përgjegjës që përcakton kushtet zhvillimore për një pronë të caktuar, ndërkohë që leja e ndërtimit është dokumenti që përshkruan të gjitha kushtet për kryerjen e punimeve të ndërtimit në përputhje me dokumentacionin shoqërues të aplikimit, në të cilat përfshihet projekti inxhinierik konstruktiv, strukturor, planimetrik, elektrik etj. Në lejen e ndërtimi janë të mirëpërcaktuara sipërfaqet e ndërtimit, sipërfaqet e përbashkëta, sipërfaqet në përdorim të publikut, që krijohen pas realizimit të veprës së re, të ndara për çdo njësi, apo strukturë ndërtimi.

Kështu, sipas legjislacionit, nëse autoriteti i përcaktuar nga ligji ka miratuar dhënien e lejes së ndërtimit dhe e ka dorëzuar atë tek kërkuesi, është e qartë për këdo si për pronarin e truallit, ashtu edhe për investonin apo sipërmarrësin, ndërtimi dhe vepra konkrete që do të rezultojë në përfundim të punimeve, mbi bazën e të cilave, secila prej palëve ka interesat dhe të drejtat e pronësisë të shprehura në aktmarrëveshjet ligjore të lidhura ndërmjet tyre.

Nëse projekti i miratuar rishikohet gjatë fazës së kryerjes së punimeve dhe ky rishikim sjell ndryshim të tij, qoftë në zvogëlim apo në rritje të sipërfaqes ndërtimore apo vëllimit të ndërtimor, kjo në praktikë ndikon drejtpërdrejt dhe mund të përbëjë shkak për cenim të të drejtave dhe interesave të titullarit të pronësisë, pra të pronarit të truallit, apo të atyre subjekteve që, përgjatë realizimit të veprës, kanë lidhur kontrata porosie apo sipërmarrjeje për njësi ndërtimore që, pas përfundimit, do të kalojnë në pronësinë e tyre.

Për më tepër, ndryshimi i projekteve përgjatë realizimit të veprës mund të sjellë edhe ndryshim të mënyrës së përdorimit dhe shfrytëzimit të sendit të paluajtshëm që do të krijohet në të ardhmen. Në këtë mënyrë, kjo mund të përbëjë shkak që shumë kontrata të lidhura, të drejta apo detyrimeve të krijuara, si dhe të drejta reale të tjera të krijuara bazuar në kushtet e parashikuara nga projekti i mëparshëm, mund të cenohen për sa u takon kushteve përkatëse të vendosura midis palëve.

Në këtë mënyrë, kur faktikisht ndryshimi i projektit gjatë zbatimit të tij sjell ndryshim të veprës që po ndërtohet, është e nevojshme që ligjbërësi në këto ndryshime ligjore, duhet të mbajë parasysh edhe rregullimin e procedurës së rishikimit të lejes së ndërtimit dhe projektit me qëllim që ndryshimi i saj të shoqërohet me pjesëmarrjen dhe shprehjen e vullnetit edhe të pronarit të pasurive pronë private, mbi të cilin ndërtohet vepra.

Sipas pikës 2, të nenit 8 të ligjit nr. 42/2019 të miratuar, rishikimi i kushteve apo ndryshimi i projektit gjatë ndërtimit kryhet nga autoriteti që e ka miratuar lejen, mbi kërkesën e arsyetuar të **subjektit të pajisur me lejendërtimi**, të shoqëruar me relacionin përkatës, të firmosur nga projektuesi dhe mbikëqyrësi i punimeve.

Kështu, në këtë proces të rishikimit të projektit, nuk parashikohet dhënia e pëlqimit apo konsultimi me pronarët e trojeve mbi të cilin realizohet vepra, edhe pse titujt e pronësisë së tyre mbi tokën, janë pjesë e shënimeve në aktin e lejes së ndërtimit dhe kusht bazë për tu plotësuar në dhënien e saj.

Në kushtet kur e drejta e pronës private është një e drejtë themelore e parashikuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, dispozitat ligjore dhe ndërhyrjet në legjislacion që kanë lidhje me të drejtën e pronësisë apo me të drejtat e tjera reale që lidhen me të, duhet të jenë të mirëmenduara, të qarta dhe të plota me qëllim që, aplikimi në praktikë të mos cenojë aspak dhe në asnjë rast këtë të drejtë.

Titullari/ët i/e të drejtës së pronësisë me nënshkrimin e dokumenteve të domosdoshme në aplikimin e lejes zhvillimore apo ndërtimore, është vendosur në një marrëdhënie të caktuar me vullnetin e tij të lirë dhe pa vese, si dhe në kushte të qarta të përfitimit apo pasojave të mundshme.

Një proces rishikimi me qëllim ndryshimin e një projekti konkret, të miratuar dhe të aplikuar në praktikë, sjell detyrimisht një realitet të ri për palët në kontratë. Nëse ndryshimet në projekt prekin sipërfaqet ndërtimore që lidhen drejtpërdrejt me të drejta pronësie të shtuara apo pakësuar, atëherë detyrimisht ndryshimet e projekteve duhet t'i shtrohen me çdo kusht për konsultim dhe pronarëve të trojeve, në mënyrë që për çdo ndryshim që pakëson apo shton të drejtat e pronësisë, i prek ato pozitivisht apo i përkeqëson, të shprehet me vullnetin e të dyja palëve nëpërmjet një akti të ri që të jetë subjekt i trajtimit nga institucionet vendimmarrëse shtetërore.

Dispozita e nenit 8 të ligjit nr. 42/2019, objekt shqyrtimi, nuk parashikon zgjidhjen e kësaj situate. Ato nuk parashikojnë sesi do të zgjidhen ato çështje që lindin për shkak të mosdakordësisë së pronarit në rastet e ndryshimit të projektit, ashtu sikundër nuk parashikojnë as detyrimin e investitorit apo sipërmarrësit të njoftojnë dhe të konsultohet me pronarin e truallit mbi gjendjen që ka diktuar nevojën për të ndryshuar dokumentin bazë, mbi të cilin po realizohet vepra.

Në këtë mënyrë, me paqartësinë dhe dykuptimësinë që ka kjo dispozitë bëhet e pakuptueshme mbi mënyrën sesi ajo do të aplikohet në praktikë për të respektuar të gjithë të drejtat reale të lidhura me të drejtën e pronësisë, që janë përfituar apo kanë lindur bazuar në projektin e mëparshëm, i cili po ndryshon.

Pikërisht kjo paqartësi dhe mungesë rregullimi prej ligjit mbi ruajtjen dhe respektimin e të drejtave të fituara, të cilat mund të preken nga ndryshimi i projekteve fillestare, si dhe mosparashikimi në ligj i detyrimit të sipërmarrësit dhe investitorit për të njoftuar pronarin e pasurisë pronë private përpara ndryshimit të kushteve dhe projekteve të miratuara në pronën e tij, **përbën cenim të parimit të sigurisë juridike**.

Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj, ka arsyetuar gjatë mbi respektimin e parimit të sigurisë juridike, si një nga shtyllat e respektimit të shtetit të së drejtës. Gjykata Kushtetuese citon se:

“Siguria juridike parakupton, veç të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me faktin se qytetari nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve normative që cenojnë dhe përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Parimi kushtetues i shtetit të së drejtës do të konsiderohet i dhunuar, nëse mohohen ose shkelen siguria juridike, stabiliteti ligjor dhe mbrojtja e pritshmërive të ligjshme. Ligjvënësi nuk mund të përkeqësojë në mënyrë të paarsyeshme gjendjen ligjore të personave, të mohojë të drejtat e fituara ose të shpërfillë interesat legjitime të tyre. Për të kuptuar dhe zbatuar drejt këtë parim, kërkohet, nga njëra anë, që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t’i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të dhe, nga ana tjetër, vetë ligji të mos qëndrojë statik nëse duhet t’i japë formë një koncepti, siç është ai i drejtësisë në një shoqëri që ndryshon me shpejtësi”. (shih vendimin nr. 36, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese, etj).

Referuar këtij arsyetimi të Gjykatës Kushtetuese, dispozita e nenit 8 të ligjit nr. 42/2019, duket se e cënon haptazi parimin e sigurisë juridike.

Siç e përmendëm edhe më sipër dispozita ligjore që pretendohet të ndryshohet nëpërmjet nenit 8 të ligjit nr.42/2019, rregullon si çështjet për ndryshimin e projekteve ndërtimore që aplikohen për një investim publik shtetëror ashtu dhe të atyre me karakter privat.

Nëse qeveria dhe Kuvendi i Shqipërisë, nëpërmjet këtyre ndryshime në ligj synojnë të rregullojnë ato çështje që kanë lindur, apo lidhen me rishikimin e kushteve të lejes dhe ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit për veprat ndërtimore të sipërmarrjeve publike, atëherë ky qëllim duhet të shprehet qartë dhe të parashikohet në mënyrë të plotë në dispozitën e propozuar për ndryshim, duke përmirësuar kështu përmbajtjen e saj.

Presidenti i Republikës, vlerëson të domosdoshme të theksojë se ndërhyrjet në dispozitat e ligjit nr. 107/2014, duhet të jenë në harmoni me kuadrin ligjor në fuqi të prokurimit publik dhe partneritetit publik privat në mënyrë që çdo ndryshim ligjor që bëhet dhe që ka si synim parashikimin me ligj të ndryshimit të projekteve për veprat publike infrastrukturore gjatë zbatimit të tyre, të mos devijojë nga zbatimi i kuadrit ligjor ekzistues, si dhe të garantojë ruajtjen dhe mirëpërdorimin e financave publike. Në këtë mënyrë çdo ndërhyrje në ligj nuk duhet të krijojë asnjë hapësirë për keqinterpretim, gjë e cila mund të sjellë në praktikë keqpërdorim të fondeve publike e rrjedhimisht dhe cënim të interesit publik.

Nëse ky ndryshim ligjor i referohet aplikimit për projektet ndërtimore apo veprave me iniciativë private, atëherë ligjvënësi duhet të qartësojë në mënyrë të sigurtë dhe shteruese, se cila do të jetë procedura për realizimin e procesit të konsultimit, midis pronarëve të truallit, investitorëve dhe sipërmarrësve për ndryshimin e kushteve të lejes dhe projekteve gjatë fazës së zbatimit. Në këtë mënyrë mund të shmangen në praktikë konfliktet gjyqësore midis palëve, si dhe për të qartësuar detyrimet e secilit, përfshi këtu dhe detyrimet e autoritetit publik, kur ndryshimet në projekt vijnë për shkak të ndërhyrjes së interesit publik dhe që duhet të përkojnë më një shpërblim të drejtë për kostot që kjo ndërhyrje shkakton në dëm të interesave të palëve private.

Gjithashtu një tjetër problematikë e evidentuar në procedurën e propozimit dhe miratimit nga Këshilli i Ministrave, rezulton të jetë fakti se projektligji nuk është konsultuar me ministrinë e tjera të lidhura më këtë çështje, apo me grupet e interesit.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka hartuar projektligjin, por nuk ka kryer një proces konsultimi publik sipas kërkesave të ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Sipas nenit 1, pika 1 të ligjit nr.146/2014, procesi i konsultimit publik është i detyrueshëm të kryhet edhe për projektligjet, ndërkohë që, sipas nenit 2/5, të po këtij ligji konsultim publik është tërheqja e mendimeve dhe sugjerimeve të palëve të interesuara për përmbajtjen dhe përmirësimin e projektaktit, nga momenti i publikimit të projektaktit deri në miratimin përfundimtar të tij.

Në këtë proces, rezulton se janë shkelur gjithashtu edhe parashikimet e nenit 24 dhe 25 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dispozita këto që parashikojnë bashkërendimin e detyrueshëm midis propozuesit të aktit dhe ministrive apo institucioneve të tjera.

Në këto dispozita parashikohet që propozuesit e akteve i dërgojnë për mendim ministrive dhe institucioneve të tjera të interesuara projektaktin dhe relacion shpjegues për objektin, qëllimin dhe përmbajtjen e tij. Jo vetëm që ky proces i konsultimit publik dhe i bashkërendimit të detyrueshëm institucional nuk është kryer, por për më tepër Këshilli i Ministrave rezulton t’i ketë propozuar Kuvendit të Shqipërisë shqyrtimin e projektligjit me procedurë të përshpejtuar. Nga shqyrtimi i relacionit të Këshillit të Ministrave, nuk rezulton e arsyetuar se përse është shmangur procesi i konsultimit publik dhe i bashkërendimit institucional dhe cila është nevoja urgjente e shfaqur për shqyrtimin e këtij projektligji me procedurë të përshpejtuar.

Kuvendi i Shqipërisë, si institucion që duhet të ushtrojë kontroll dhe mbikqyrje ndaj veprimtarisë ekzekutive kishte për detyrë të verifikonte nëse Këshilli i Ministrave kishte respektuar ose jo, zbatimin e ligjit në procesin e konsultimit publik dhe bashkërendimit institucional.

Nga shqyrtimi i praktikës parlamentare rezulton se Kuvendi nuk e ka kryer një verifikim të kësaj natyre, por për më tepër me vendimin nr.73, datë 20.6.2019, ka miratuar shqyrtimin e këtij projektligji me procedurë të përshpejtuar, duke legjitimuar kështu shmangien e zbatimit të parashikimeve të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 dhe ligjit nr.146/2014, të kryer nga Këshilli i Ministrave.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Shqipërisë,

Për arsytet e parashtruara më sipër, në bindje të Kushtetutës dhe në ushtrim të së drejtës të parashikuar në pikën 1, të nenit 85 të saj, Presidenti i Republikës ka vendosur kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 42/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014 ‘Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit’, të ndryshuar” me qëllim që Kuvendi i Shqipërisë të rishikojë dhe të përmirësojë nenin 8 të këtij ligji.

The image shows the official circular stamp of the President of the Republic of Albania. The text around the border reads "REPUBLIKA E SHQIPËRISE" at the top and "-PRESIDENTI" at the bottom. In the center is the coat of arms of Albania. Overlaid on the stamp is a handwritten signature in blue ink. The name "Singerisht" is written in black text above the signature, and "Ilir Meta" is written in black text below the signature.